REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:104502
Datë: 16.02.2024
Numri i dokumentit: 05341753

CP.nr.107/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, përmes gjyqtarit individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në lëndën përmbarimore të kreditorit R.B nga Mitrovica, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Halil Dërguti, avokat me seli në Mitrovicë, ndaj debitorit Spitali i Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri"-Mitrovicë, që zhvillohet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, jashtë seancës gjyqësore me datë 16.02.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore e kreditorit R.B nga Mitrovica, ndaj debitorit Spitali i Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri"-Mitrovicë.

Arsyetim

Me aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.107/2020 e datës 15.01.2020 është caktuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit R.B nga Mitrovica, ndaj debitorit Spitali i Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri"-Mitrovicë.

Me shkresën e datës 13.02.2024, përfaqësuesi i kreditorit, av.Halil Dërguti, ka njoftuar Gjykatën se borxhi i kreditors në këtë çështje është ekzekutuar.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 i LPP-së, i cili flet për përfundimin e procedurë përmbarimore ma saktësisht par. 4 i po të njejtit nen thotë citoi "Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret

2023:104503

vendim për përfundimin e procedures përmbarimore", e nga të lartëcekurat pasiqë borxhi është paguar në tërsi e PËRFUNDOJ procedurën përmbarimore.

Nga arsyet e cekura si më lartë, e konform nenit 66 paragrafi 4 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përmbarimore) është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

CP.nr.107/2020, datë 16.02.2024

GJYQTARI

Fuad Haliti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.